

## DEPARTAMENTI KIRURGJKAL KARDIO-VASKULAR

### FLETE MIRATIMI PER PROCEDUREN ANGIOGRAFIA KORONARE

Emri ..... Mbiemri .....

#### PROCEDURA

Yndyra (kolesteroli) dhe kalciumi mund te ngushtojne arteriet ashtu si edhe ndryshku ngushton tubacionet e vjetra te,ujit. Ky ngushtim mund te ndaloje rrjedhjen e gjakut ne drejtim te zemres. Kjo mund te shkaktoje angine (dhimbje ne gjoks) apo goditje ne zemer (infarkt miokardi). Procedure e koronarografise kryhet me qellim qe te zbulohet shkalla e semundjes se arterieve koronare, te cilat jane enet qe furnizojne me gjak zemren. Pas injektimit lokal te nje sasie te vogel te lendes anestetike, nje tub i holle (kateter) vendoset ne nje arterie ne rreze te kofshes apo ne krah. Tubi vendoset me kujdes ne seclien prej arterieve koronare (arteria koronare e majte dhe .arteria koronare e djathte). Me pas, duke perdorur rrezet X dhe lende kontrasti qe behet e dukshme nen rrezet X realizohen disa filma te shkurter. Keto filma na tregojne se si jane arteriet koronare. Ky informacion na lejon qe te zbulojme nese ka ndonje ngushtim apo bllokim ne arteriet tuaja koronare.

Lenda e kontrastit mund te injektohet ne dhomen qendrore te zemres (ventrikuli i majte). Kjo sherben per te matur madhesine e zemres dhe per te vleresuar se si eshte funksioni pompe i saj. Ne baze te te dhenave te marra ne mund t'ju tregojme juve se cili trajtim eshte me i mire per ju. Ky mund te jete nje operacion si by-pass-i koronar apo angioplastika (arteriet koronare zgjerohen duke perdorur nje tullumbac te vogel). Ne disa raste, mund te jete e mjaftueshme terapia me barna•

#### RREZIQET E PROCEDURES

Rreziqet e angiografise koronare varen nga:

- Shkalla e semundjes se arterieve tuaja koronare ( sa e rende eshte semundja )
- Funksioni I zemres suaj ( sa mire e pompon gjakun )
- Moshja juaj ( sa i / e vjeter jeni )
- Gjendja e pergjithshme shendetesore e juaja.
- Gjendja e oganeve tuaja te tjera.

Rreziku eshte me i larte nese ju keni kryer me pare nje tjetere operacion by-pass-i.

*Me poshte jane paraqitur disa. prej rreziqeve me serioze qe lidhen me proceduren e angiografise koronare, por keto nuk jane te vetmet rreziqe:*

#### Me pak se 1 ne 10,000 njerez

- a. Demtim i lekures nga rrezatimi, qe shkakton skuqje te saj



#### 1 ne 1000 njerez

- b. Goditje ne tru (insult). Kjo mund te coje ne paralize per nje kohe te gjate.
- c. Goditje ne zemer (infarkt miokardi).
- d. Reaksion serioz ndaj lendes se kontrastit. Nese kjo ndodh, ju mund te perjetoni reaksione te renda si astem, shok dhe konvulsione.

#### Ne raste jashtezakonisht te rralla, 1 ne 250,000 deri 400,000 injeksione mund te ndodhe vdekje.

- e. Nevoje per nderhyrje kirurgjikale ne kembe ne vendin e shpimit ne kembe.
- f. Nevoje urgjente per nderhyrje kirurgjikale-by-pass apo angioplastike koronare.
- g. Nje rrezik me i larte gjate per semundje malinje si pasoje e ekspozimit ndaj rrezeve X.
- h. Vdekje.

#### 1 ne 100 njerez

- i. Zemra mund te mos rrahe ne menyre normale dhe kjo mund te beje te domosdoshme nje nderhyrje urgjente.
- j. Riparim kirurgjikal ne vendin e shpimit ne rreze te kofshes. Kjo mund kerkoje zgjatjen e kohes se qendrimit ne spital.
- k. Reaksione te nje shkalle rendesie te vogel ndaj lendes se kontrastit.
- l. Humbje te funksionit renal per shkak te veprimit te lendes se kontrastit.

#### 1 ne 20 njerez

- m. Mavijosje, skuqje dhe enjtje e permasave te medha ne vendit e shpimit.

#### Shumica e njerezve

- n. Mavijose - irrim i vogel ne vendin e shpimit.

### RREZIQET E RENDESISHME DHE ALTERNATIVAT E TRATTIMIT

Mjeku me ka shpjeguar mua te gjitha rreziqet e rendesishme dhe problemet qe lidhen ne menyre specifike me mua si edhe ecurine e gjendjes sime ne rast se ndodhin komplikacionet e mundshme. Mjeku me ka shpjeguar edhe alternativat e mundshme te trajtimit si edhe rrezikun ne rast se nuk do te kryej rocedure.

### MIRATIMI I PACIENTIT

Une pranoj se:

Mjeku me ka sqaruar rreth gjendjes sime shendetesore dhe procedures se propozuar. Une kuptoj rreziqet e procedures, te anestezise si dhe rreziqet qe jane specifike per gjendjen time shendetesore, si edhe rezultatin e prishem.

Mjeku me sqaroi edhe mundesite e tjera te pershtatshme te trajtimit si dhe rreziqet e tyre. Mjeku me sqaroi prognozen dhe rreziqet qe lidhen me mos-kryerjen e kesaj proced



Mua m`u dha mundesia te pyes mjekun dhe te paraqes sbqetesimet lidhur me gjendjen time shendetesore, proceduren dhe rreziqet e saj dhe mundesite e trajtimit tim. Pyetjet dhe shqetesimet e reja u diskutuan dhe mora pergjie te plote nga mjeku. ne e kuptoj se, ne rast te nje komplikacioni to mundshem, mund te kern nevoje per transfusion gjaku, procedure shtese apo nderhyrje kirurgjikale. Une kuptoj se procedura mund te kryhet nga nje mjek tjetet i specializuar. Mjeku me ka sqaruar se ne rast te komplikacioneve te menjehershme kercenuese per jeten gjate procedures, ato do te trajtohen ne perputhje me rrethanat.

Une e kuptoj se nuk mund te kete garanci se procedura do te permiresoje gjendjen time shendetesore. Bazuar ne te gjitha keto,

### UNE KERKOJ TE KRYEJ PROCEDUREN

Emri i pacientit/ose familjarit ..... Firma .....

Data .....

### SQARIMI I MJEKUT

Une kam sqaruar rreth:

- ✓ gjendjes shendetesore te pacientit
- ✓ nevojës per trajtim .
- ✓ pasojave lidhur me mos trajtimin
- ✓ procedures dhe komplikacioneve to saj
- ✓ mundesive te tjera te trajtimit dhe komplikacioneve te tyre
- ✓ pasojave to mundshme nese keto komplikacione ndodhin
- ✓ komplikacioneve dhe problemeve specifike per kete pacient

Une i kam dhene mundesine pacientit:

- ✓ te pyese rreth ceshtjeve te trajtuara me siper - te paraqese cfaredo shqetesimi tjetet
- ✓ te cilave i jam pergjigjur ne menyre to plote dhe to qarte.

Une jam i mendimit se pacienti kuptoi informacionin e mesiperm.

Emri i Mjekut ..... Firma .....

Data .....